



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
REKTORATI

Nr. 1551 Prot

Gjirokastrë, më 14.10. 2024

Miratoi  
Rektori

Prof. dr. Jaho Çana



**Lënda:** Hapen thirrjet për shkrim projekt propozimesh në kuadër të programit Research Expertise from Academic Diaspora (READ).

Në kuadër të Programit Research Expertise from Academic Diaspora (READ), janë hapur thirrje të reja për projekt propozime, si më poshtë vijon:

Nr	Thirrja	Dorëzimi i dokumentacionit
1.	Research Expertise from Academic Diaspora (READ)	05 dhjetor 2024

Ky program mbështet kërkuesit dhe lektorët shqiptarë të cilët aktualisht punojnë në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri në bashkëpunim me kërkues/lektorë shqiptarë të angazhuar në institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Aktivitetet kryesore që mbështet ky program janë si më poshtë:

- Kërkim shkencor i përbashkët për publikime në revista me faktor të lartë impakti;
- Mbikëqyrje të doktoraturave në Shqipëri me mentorë nga Diaspora Shkencore;
- Zhvillim e përmirësim kurrikule dhe hartimi i programeve të përbashkëta;
- Bashkë-mësimdhënie.

Studiuesit rezidentë shqiptarë duhet të zotërojnë të gjitha kualifikimet e mëposhtme për t'u kualifikuar për Programin READ:

- Pedagog/studiues shqiptar që aktualisht punon në një institucion të arsimit të lartë (IAL) të akredituar në Shqipëri.

- Zotëron titullin PhD ose diplomë tjetër terminale, trajnime ekuivalente profesionale ose përvojë në kohën e aplikimit.
- Më shumë se 5 vjet përvojë pune në një universitet apo qendër kërkimore në Shqipëri.
- Njohuri të gjuhës angleze të përshtatshme për projektin kërkimor që do të kryhet në Shqipëri.
- Njohuri në fushën e ekspertizës dhe gatishmëri për të bashkëpunuar me studiuesin e Diasporës
- Një ekip me dy ose më shumë studiues nga IAL-të ka një avantazh.

Ju mund të regjistroheni dhe të ndiqni webinarë online në link-et e mëposhtme:

- **Wednesday, October 30, 2024, at 17:00 Central Europe Time**
- **Monday, November 11, 2024, at 10:00 Central Europe Time**
- **Wednesday, November 27, 2024, at 18:00 Central Europe Time**

Thirrjet, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin e Research Expertise from Academic Diaspora (READ) (<https://www.iie.org/programs/research-expertise-from-the-academic-diaspora/>).

Gjithashtu, mund të kontaktoni **READ@iie.org** ose Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

**Zv. Rektore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor**

**Prof. asoc. Merita Isaraj**

